




Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republike of Kosovo
Komuna e Dragashit / Opština Dragaš / Dragas Municipality
Zyra e Kryetarit/Kancelarija Predsednika/President office



KUVENDI I KOMUNËS NË DRAGASH

Ne baze të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 32.2 të Statutit të Komunës së Dragashit - 01 Nr.06-103/1 të datës 11.09.2008, Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 02/2019, për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Dragashit, Kuvendi i Komunës në Dragash në mbledhjen e mbajtur me datën, 28.06.2022, pas shqyrtimit dhe votimit paraprak miraton këtë:

V E N D I M PËR EMËRIMIN E KOMISIONIT PËR UDHËHEQJEN DHE KOORDINIMIN E PUNËS NË TERREN PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLAVE LOKALE

I. Me këtë vendim emërohet komisioni për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokale në fshatra, vendbanime dhe lagje urbane në territorin e komunës së Dragashit.

II. Komisioni sipas pikës I të këtij vendimi përbëhet prej 7 (shtatë) anëtarëve, ku 4 (katër) anëtar janë nga Kuvendi i Komunës, 1 (një) anëtar përfaqësues fshati, vendbanimi, si në vijim:

- 2.1 Mehmet Spahiu – LDK, anëtar nga Kuvendi i Komunës,
- 2.2 Driton Ademi – PDK, anëtar nga Kuvendi i Komunës,,
- 2.3 Uran Halimi – VV, anëtar nga Kuvendi i Komunës,
- 2.4 Munir Jonuzi – VAKAT, anëtar nga Kuvendi i Komunës,
- 2.5 Resul Fetahu , anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
- 2.6 Fejsal Halilović anëtar nga Ekzekutivi i Komunës,
- 2.7 _____ përfaqësues nga fshati apo vendbanimi.

III. Kryesues i komisionit zgjedhet me konsensus të brendshëm të anëtarëve të komisionit.

IV. komisioni është përgjegjës për caktimin e periudhës kohore të mbajtjes së zgjedhjeve për anëtar dhe kryetar të këshillave lokale të fshatrave, vendbanimeve në komunën e Dragashit.

V. Komisioni ka për detyrë që nëpërmjet të mjeteve të informimit, web faqes së komunës, tabelave të shpalljeve, objekteve publike, dhe hapësirave të frekuentuara dhe platformave të tjera të komunikimit të informojë qytetarët 15 ditë para datës së mbajtjes së takimit me qytetarë për zgjedhjen e këshillave lokale.

VI. Komisioni ka për detyrë që të mbajë procesverbal për çdo takim me qytetarë dhe i njëjti duhet të përmbajë datën, orën dhe vendin e mbajtjes së takimit, numrin dhe listën e pjesëmarrësve dhe i njëjti të nënshkruhet nga kryesuesi i takimit.

VII. Obligohet komisioni që punët të kryej duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ (MAPL) Nr.02/2019 për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane.

VIII. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Dragash, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës MAPL dhe 7 ditë pas publikimit në web-faqën zyrtare të Komunës

01-Nr- 06d/01-13845-4/22
Datë 28.06.2022



Kryesuesi i Kuvendit

Oran Halimi